



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM PËR MEDIA

Ditën e mërkurë, në datën 8 shkurt 2023, në mjediset e Autoritetit të Mediave Audiovizive, (AMA) u zhvillua mbledhja e radhës së AMA-s, ku morën pjesë anëtarët e mëposhtëm:

Armela	KRASNIQI	Kryetar
Desada	Metaj	Zëvendëskryetar
Aurela	BICJA	Anëtar
Besian	ZOGAJ	Anëtar
Gjergji	HAMITI	Anëtar
Jetmir	HALILAJ	Anëtar
Joana	ALLUSHI	Anëtar

AMA, pas shqyrtimit të çështjeve të rendit të ditës vendosi:

1. Miratimin e planit të ri frekuencor për transmetimet numerike tokësore (470-694)” **(Vendimi nr. 1, datë 08.02.2023).**
2. Mosrinovimin dhe konstatimin e pavlefshmërisë së licencës së shoqërisë “Radio Mati” sh.p.k., për subjektin audio privat “Radio Mati” **(Vendimi nr. 2, datë 08.02.2023).**
3. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Tele. Co. Albania” sh.p.k., për ofrimin e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor Tele.Co.Albania” **(Vendimi nr. 3, datë 08.02.2023).**
4. Rinovimin e autorizimit të shoqërisë “Masa Grup” sh.p.k., për përsëritjen e shërbimit të programit audioviziv mbështetur në rrjet kabllor “Masa Grup” **(Vendimi nr. 4, datë 08.02.2023).**
5. Ndëshkimin e shoqërisë “Top Channel” sh.a., licencuar për subjektin audioviziv privat kombëtar “TV Top Channel”, me vendimin për dënimin me gjobë në masën 200, 000 (dyqindmijë) lekë”, për shkelje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe Kodit të Transmetimit miratuar me vendimin nr. 228, datë 11.12.2017, të AMA-s **(Vendimi nr. 5, datë 08.02.2023).**
6. Refuzimin e ankimit administrativ të paraqitur nga subjekti person fizik Guri Meko dhe lënien në fuqi të vendimit për dënimin me gjobë nr. 15 datë 04.10.2022, vendosur ndaj subjektit OSHMA “TV kabllor Aral” **(Vendimi nr. 6, datë 08.02.2023).**

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE